REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

VENDIM

Nr.2 datë 14/09/2020

"PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN DHE PROPOZIMIN NË KUVENDIN E SHQIPËRISË TË PROJEKTLIGJIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10019, DATË 29.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 18, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

VENDOSI:

I. Ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe propozimin në Kuvendin e Shqipërisë të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.115/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar"".

II. Grupi i punës përbëhet nga 3 deputetë, anëtarë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si më poshtë:

1. Damian Gjiknuri
2. Klotilda Bushka
3. Korab Lita

III. Grupi i punës do të asistohet në veprimtarinë e tij nga ekspertët e reformës zgjedhore.

IV. Drafti përfundimtar i projektligjit, me qëllim vazhdimin e procedurave parlamentare për depozitimin e tij, duhet të paraqitet në Komisionin për Çështjet Ligjore brenda datës 30.09.2020.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ULSI MANJA

Tiranë 14.9.2020